Re: Thirrje për takim

Fatir Berzati

Tue 9/30/2025 8:58 AM

To:Artan Abdurrahmani <Artan.Abdurrahmani@rks-gov.net>; Lirije Fejza <Lirije.Fejza@rks-gov.net>;

Cc:Erden Atiq <erden.atiq@rks-gov.net>;

Ne takimin e planifikuar prr diten e djeshme ne oren 09:30, edhe pse e konfirmuat pjesemarrjen ju nuk moret pjese, edhe pse ishit prezent ne komune.
Per kete takim kane qene ne gatishmeri edhe inspektoret tjere, perveq juve, qe deshironi mi ike pergjegjesise dhe mundoheni me ikje me i fsheh faktet qe ju dosjet zyrtare i keni nxjerr nga zyra.
Sa i perket pretendimeve tuaja per zyre, edhe nje here po e potencoj, qe zyra nuk eshte personale e juaja, dhe aty ka edhe zyrtare tjere dhe zyra nuk eshte e mbyllur, e as cilindri nuk eshte thyer, por meqenese ju jeni i prirur per manipulim dhe viktimizim, institucioni Nuk merret me defekte te tilla personale.
Ju dje Nuk pranuat me qene ne zyre sepse ju po deshironi me qene vet ne zyre, cka ngrit dyshime qe ju deshironi me i asgjesu provat te cilat nuk jane ne favorin tuaj. Sidomos per rastin e pales A. R., ku per kete rast do iniciohen procedura ligjore per juve dhe per personin D. A.
Gjithashtu, te njoftoj, qe potencimet tuaja me video iqizime, jane perpjekje per shantazhim per cka do te ndermirren hapat e nevojshem per denoncim ne organet kompetente.

Prr fund, meqenese ju nuk patet gatishmeri per realizimin e takimit, une si drejtor i DI, kam shterur te gjitha rruget e komunikimit, por ju nuk keni gatishmeri per kontstruktivitet dhe keni zgjedhur rrugen e shpifjeve, manipulimeve, viktimizimit dhe perpjekjeve per frikesim dhe shantazh. E per te gjitha keto, do te ndermerren hapat ligjor ne institucionet kompetente.

Gjithashtu, ju rikujtoj, qe ju Nuk keni dorezu ende raport per kontraten per ndriqimin publik, siq obligiheni sipas pikes 3 te Vendimit te kryetarit Nr. 01-030/01-0014100/25 te dates 27.08.2025, ku i keni pas 15 dite nga data e vendimit.

Get Outlook for iOS

From: Artan Abdurrahmani <Artan.Abdurrahmani@rks-gov.net>
Sent: Sunday, September 28, 2025 9:35:47 PM
To: Fatir Berzati <fatir.berzati@rks-gov.net>; Lirije Fejza <Lirije.Fejza@rks-gov.net>
Cc: Erden Atiq <erden.atiq@rks-gov.net>
Subject: Re: Thirrje për takim

Z, Berzati po vazhdoni të paraqitni vehten si të liruar nga përgjegjësia ligjore, dhe mohoni faktin e uzurpimit dhe ndrrimit të cilindrit të çelësit në zyren time, ku për këtë janë provat dhe dëshmitar si dhe inqizmet ku ju deklaroheni dhe kërkoni nga unë të liroj zyren dhe të dorhiqem nga detyra e inspektorit.

Është e dukshme se veprimet tuaja janë ndërmarrë me qëllim të caktuar për të marrë dokumentacionin zyrtar nga zyra ime dhe për të shfrytëzuar të dhënat zyrtare që gjenden aty. Këto veprime janë bërë me synim të sajimit apo fabrikimit të fakteve të pavërteta kundër meje, ndonëse keni qenë të informuar se një gjë e tillë

përbën shkelje të ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve, si dhe cenim të së drejtës themelore për ushtrimin e funksionit tim zyrtar.

Ju e dini shumë mirë se, përveç rastit të Rakiqeviçit i cili është raportuar tek ju me date 24.03.2025 dhe është deleguar nga ana juaj tek menaxheri i kontratës për ndarje të buxhetimit për demontim, konfiskim dhe deponim të saksiave. Të gjitha rastet e tjera janë të përmbyllura. Po ashtu, ju siguroj se asnjëherë nuk keni paraqitur kërkesë zyrtare për përmbylljen e rasteve, për faktin se për një gjë të tillë nuk ka ekzistuar asnjëherë nevoja. Arsyeja është se unë, gjithmonë kam qenë në krye të detyrës dhe i kam përmbyllur rastet në pajtim me procedurat ligjore dhe administrative, për çka ju i posedoni edhe raportet periodike të dërguara nga unë. Tani, pasi që keni thyer cilindrin e zyrës sime dhe keni siguruar qasje në dokumentacionin zyrtar, çdo pretendim juaj tjetër paraqet vetëm përpjekje për manipulim dhe pasqyrim të vetes si recidivist dhe shkelës i ligjit.

Tentimi juaj për të marr marrë procesverbalet e një inspektori dhe t'ia kalojë një tjetri, përbën tejkalim të autorizimeve administrative dhe sanksionohet edhe me kodin penal. Një veprim i tillë do të konsiderohet: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, si dhe tentim për ndryshim apo shkatërrimi të provave zyrtare. Këto janë dokumente zyrtare që mbeten përgjegjësi e inspektorit që i ka hartuar. Procesverbali, si akt zyrtar, mbetet ekskluzivisht përgjegjësi e inspektorit që e ka hartuar. Ai ka fuqi provuese dhe përbën dokument që lidhet drejtpërdrejt me përgjegjësinë profesionale të inspektorit që ka kryer kontrollin. Çdo ndërhyrje arbitrare mbi të cenon integritetin e procesit administrativ dhe krijon pasoja të drejtpërdrejta juridike për personin që e ndërmerr një veprim të tillë.

Prandaj, unë konfirmoj pjesëmarrjen në takimin e thirrur në zyrën tuaj, por jo për të ndërmarrë veprime të kundërligjshme siç janë deklaruar nga ana juaj. Nga ky takim pres që ju, në përputhje me ligjin, të reflektoni dhe të formoni një komision zyrtar i cili, përmes një procesverbali të ligjshëm, të konstatojë gjendjen faktike të zyrës sime dhe të më kthejë çelësin e saj si dhe qasjen e plotë në të gjitha dokumentet zyrtare.

Me respekt!
Artan Abdurrahmani
Inspektor i shërbimeve publike

From: Fatir Berzati
Sent: Friday, September 26, 2025 10:34:24 PM
To: Artan Abdurrahmani
Cc: Erden Atiq
Subject: Thirrje për takim

I nderuar,

Ju thërras të hënën, më 29.09.2025, në orën 09:30, në zyrën time.

Keni obligim të sillni çelësat e billboard-it, dokumentacionin shoqërues dhe të gjitha procesverbalet e mbajtura. Ju kujtoj se disa herë kam kërkuar raportet dhe listën e rasteve të hapura që nga gushti, por ato nuk janë dorëzuar. Përveç rastit Rakiqeviq, keni lënë të papërfunduara edhe shumë raste të tjera.

Rastet e pambyllura do t'u kalojnë inspektorëve të tjerë, sipas kompetencës ligjore të drejtorit. Mosrespektimi i këtij urdhri do të sjellë masa disiplinore për shkelje të detyrës.

Get [Outlook for iOS]